

Promovimi i Kodit të Ri të Etikës dhe Deontologjisë Mjekëore

*Dr. Din Abazaj
President i UMSH-së
13 Prill 2012*

Përpjekjet për të shpjeguar vlerat profesionale, zhvillimet dhe rëndësinë e Kodeve të Etikës janë të lashta. *“Që nga koha e Hipokratit, profesioni mjekësor ka bërë përpjekje për të patur një Kod të Etikave me qëllim rregullimin e sjelljes dhe marrëdhënieve profesionale.*

Para 10 vitesh miratuam dhe vumë në përdorim Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (Kodin e vjetër tashmë).

Kjo periudhë mund të mos konsiderohet shumë e gjatë, por zhvillimet që kanë ndodhur gjatë këtij harku kohor janë të konsiderueshme. Normale kjo për çdo vend, por aq më tepër për një vend si ky i yni, në tranzicion e në kushte zhvillimesh e reformash të reja, jo vetëm në shëndetësi, por edhe në çdo fushë të jetës dhe sjelljes shoqërore, e cila kushtëzon sjelljen tonë si profesionistë të shëndetësisë. Në sistemin tonë shëndetësor janë ndërmarrë reforma, janë miratuar ligje, janë krijuar struktura të reja, po hyjnë dhe po implementohen teknologji dhe metoda moderne diagnostikuese dhe mjekuese. Në tërësi, shkencat mjekësore në botë evoluojnë nga viti në vit, koncepte dhe metoda të reja gjithnjë më moderne futen në përdorim. Këto natyrisht e çojnë hapa përpara sistemin, dhe kjo është një e mirë e madhe, por ka një të keqe jo të vogël, sepse modernizimi dhe automatizimi i proceseve e largojnë mjekun nga kontakti me të sëmurin, shkurtojnë kohën e domosdoshme të komunikimit, të informimit të studimit nga afër të të sëmurit, për ta bërë atë bashkëpjesëmarrës në vendimmarrje për shëndetin dhe jetën e tij, ç’ka është thelbësore në procesin e marrëdhënieve mjek-pacient.

Kjo dinamikë zhvillimesh dhe prurjesh të reja ka diktuar nevojën e azhornimit dhe të fuqizimit të rregullave profesionale, të vendosjes dhe fuqizimit të normave dhe kërkesave të reja të sjelljes dhe etikës mjekësore në të gjitha vendet. Domosdoshmëria për këto ndryshime ka qenë objekt i vendimmarrjeve dhe publikimeve të një sërë deklaratah nga forume të rëndësishme ndërkombëtare, në të cilat fatmirësisht është i anëtarësuar edhe Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë.

Në këtë kuadër zhvillimesh, si edhe përvojash dhe eksperiencash të fituara dhe akumuluar, gjatë veprimtarisë tonë si organizëm u pa nevoja e rishikimit dhe azhornimit të Kodit të Etikës dhe dalja me një Kod të ri, të cilin kam kënaqësinë ta prezantoj shkurtimisht sot përpara këtij auditori të nderuar.

Dua të theksoj se, nuk është synuar dhe as pretendohet që ky Kod të ketë ndryshime thelbësore nga ai i pari. Përkundrazi, me synim të krijimit të një tradite të mirë dhe ruajtjes së vlerave është tërësisht i mbështetur në parimet e tij.

Jemi orvatur që ky Kod në dispozitat e tij të përmbajë standardet e detyrueshme për t’u aplikuar gjatë praktikës profesionale, të cilat kushtëzojnë ushtrimin e profesionit, të jetë më i

detajuar e gjithëpërfshirës në problematikë, më i kuptueshëm, më i drejtpërdrejtë, por edhe më imponues dhe detyrues për çdo profesionist për ta respektuar dhe zbatuar në praktikën e tij. Kodi është guri i themelit në sistemin e rregullave profesionale, si një komponent i rëndësishëm brenda juridiksioneve përkatëse, i cili mbron të sëmuret dhe publikun nga kequshtrimi, inkompetenca, pasiguria ose mungesa e etikës gjatë ushtrimit të profesionit.

Kodet e etikës, natyrisht që ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, por kanë të përbashkët një vlerë themelore shumë të rëndësishme, vendosjen e standardeve dhe principeve të përgjithshme të cilat udhëheqin një praktikë të mirë profesionale. Në përpunimin dhe azhornimin e këtij Kodi, ne kemi konsultuar Kode të ndryshme, si Kodin Ndërkombëtar të Etikës të Shoqatës Botërore të Mjekësisë, të Urdhrave/Dhomave të Mjekëve të Francës, Gjermanisë, Italisë, Spanjës, Britanisë së Madhe, Sllovenisë etj, nga ku kemi marrë dhe përshtatur atë ç'ka e kemi konsideruar si më esenciale dhe më të përbashkët, për të siguruar dhe ruajtur standardet dhe vlerat profesionale në çdo sistem shëndetësor siç janë:

- *Sjellja e mjekut ndaj pacientëve, konfidencialiteti, konsenti i informuar, sjellja e duhur profesionale, respektimi i të drejtës së pacientit për të zgjedhur mjekun, institucionin e mjekimit, si dhe për të qenë bashkëpjesëmarrës në vendimet klinike për trajtimin e tij, etj.*
- *Sjellja ndaj kolegëve dhe personelit tjetër mjekësor.*
- *Sjellja e mjekut si pjesë e shoqërisë civile.*
- *Detyrimi i mjekut për të marrë pjesë në programet e EVM-së, për të qenë i azhurnuar dhe për të ruajtur aftësitë profesionale.*
- *Detyrimi i mjekut për t'u angazhuar në proceset e rivlerësimeve periodike të kompetencës dhe performancës së tij profesionale, akreditimit dhe liçensimit.*

Këto, si dhe të tjera dispozita që përmban ky Kod, janë standarde të ushtrimit të profesionit përballë të cilave matet dhe vlerësohet kompetenca dhe performanca e çdo mjeku në veprimtarinë e tij. Standardet janë themeli i rregullave mjekësore pa të cilat nuk mund të ketë cilësi në ushtrimin e profesionit dhe, askush i kualifikuar apo jo, nuk mund të ushtrojë profesionin pa nevojën dhe domosdoshmërinë për të qenë i kontrolluar në veprimtarinë e tij gjatë gjithë karrierës profesionale. Në këtë kuptim, proceset rregullatore të kontrollit, të verifikimit të standardeve, dhe përcaktimi i kompetencës së nevojshme për të qëndruar në profesion, janë me shumë rëndësi për komunitetin mjekësor.

Lidhur me këtë, theksoj se, të gjitha proceset rregullatore të kontrollit dhe të verifikimit të standardeve, të cilat sigurojnë një kujdes të mirë klinik, lidhen në mënyrë të detyrueshme me procesin e liçensimit apo heqjes së liçensës. Procesi i liçensimit, ri-liçensimit apo heqjes së liçensës është masa e fundit në rregullimin mjekësor, e cila garanton një kujdes klinik të cilësisë së lartë. Kjo garanton të sëmurin se po merr një përkujdesje nga një mjek i azhurnuar dhe i liçensuar, që plotëson kushtet për të qenë një praktikues i mirë dhe i sigurt. Urdhërat/Dhomat e Shoqatave Kombëtare të Mjekëve janë të njohura ndërkombëtarisht si autoritete të vetrregullimit profesional.

Më lejoni tani, të citoj këtu poshtë një pjesë të ligjëratës me të cilën na është drejtuar Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Botërore të Mjekësisë, Dr. Otmar Kloiber në letrën e tij, me rastin e anëtarësimit të UMSH-së në këtë Shoqatë:

“ Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë është i mirëpritur si një anëtar në familjen e madhe të shoqatave kombëtare mjekësore në këtë botë. Në një kohë të ndryshimeve të qëndrueshme, ne e shohim veten si një rojë e vlerave dhe traditave tona të përbashkëta, lidhur me kujdesin, etikën, shkencën.

Le të bëjmë që ato të ndryshojnë në drejtim të më të mirës. Të kujdesesh për pacientët, të punosh dhe të sillesh në mënyrë etike dhe të aplikosh shkencën, janë themeli për t’l shërbyer më mirë pacientëve tanë. Ne si shoqata mjekësore do të bëjmë më të mirën për të aftësuar mjekët, tani dhe në të ardhmen, për të ofruar kujdes më të mirë për ta”.....përfundon letra e Dr. Kloiber

Duke përfunduar këtë prezantim po citoj fjalët e Hipokratit:*“Në çdo shtëpi ku unë vij, unë do të futem vetëm për të mirën e pacientëve të mi”.*

Ju faleminderit,

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.